

Siguria kombëtare dhe sfidat e integritit

- Krimi i organizuar
- Trafiqet ilegale
- Gjakmarrja
- Ekstremizmi islamik


Sfidat e këtij fillimshkulli

Kur autori i këtij libri, kolonel Xhavit Shala, me njohu me projektin për të shkruar "Siguria Kombëtare dhe Sfidat e Integritit" e ndjeva për detyrë ta inkurajoj e, madje, dhe i premtova të shkruaja parathënien e tij. Dhe sot, kur lexova këtë punim, kam ndjere një emocion, sa dashmires dhe inkurajues, aq edhe vlerësues, për tematiken mjaft interesante që paraqet botimi.

Po e them që në fillim që kemi të bëjmë me një botim serioz, ku autori sjell para lexuesit, qoftë atij profesionist, qoftë atij të interesuar, një seri shkrimesh analitike, të cilat janë një mundësi për të parë tej imagjinatave ose perfytyrimeve jo reale e here – here spekulative, këto tematika mjaft të kerkuara e teper problematike për shoqërinë shqiptare në tranzicion.

Problemi i sigurisë kombëtare dhe sfidat me të cilat përballët shoqëria shqiptare në rrugën drejt integritit të vendit në strukturat euro-atlantike, mbeten ndër shqetësimet kryesore të autorit, i cili edhe si profesionist e drejtues i strukturave të drejtpërdrejta të luftës kundër trafikëve të paligjshme të qenieve njerezore, kriminit të organizuar, terrorizmit dhe luftës kundër bandave kriminale etj., ka demonstruar përkushtim dhe aftësi të larta profesionale e analitike, kurajë dhe trimëri, papajtuësmeri me krimin, duke përdorur praktika dhe ide vizionare. Ishin këto tipare të tij që i siguruan edhe suksese si drejtues i drejtpërdrejtë i mjaft operacioneve.

Veshtrimi korelativ i sigurisë kombëtare në raport me krimin e organizuar, trafikun e qenieve njerezore dhe të femrave për qëllime prostitucioni, me gjakmarrjen, strategjinë e luftës kundër trafikut të makinave të luksit dhe luftën permanente kundër trafikëve, përben boshlinjën kryesore të botimit të këtij botimi. Krahas kësaj, autori me mjaft sukses ka hyrë edhe në relacionet e kriminit të brendshëm me atë nderkombëtar e deri të format e rrezikut të shfaqjes dhe të prirjes për ta përdorur vendin tonë për interesa të terrorizmit nderkombëtar. Trajtimi i këtyre problemeve nga një profesionist, që di të japë faktin dhe ngjarjen thjeshtë e bukur, krijon një vizion me real për rrezikshmerinë që paraqesin ato për shoqërinë shqiptare dhe për vetë shtetin shqiptar. Mesazhet kryesore që përshkojnë tematikat e këtij botimi janë teper domethënëse dhe me vlerë teorike e praktike.




Kesisoj, në pjesën për luftën kundër kriminit të organizuar, libri merr përsipër të analizojë shkaqet, prirjet, format dhe metodat e sofistikuar që përdoren nga autorët e këtij lloji krimi në Shqipëri, pasojat dhe rreziqet për sigurinë kombëtare, si dhe të sensibilizojë organet shtetërore dhe shoqërinë civile për mbështetjen e fuqishme që ato duhet të japin. Ai jep, jo vetëm rekomandimet konkrete profesionale, juridike e institucionale, por edhe strategjitë përkatëse për rritjen e efikasitetit të luftës ndaj kriminit të organizuar.

Duke marrë shkas nga përhapja e ekstremizmit islamik pas ngjarjeve të 11 shtatorit, autori përdor gjithë bagazhin e tij profesional në analizën e shkaqeve, prirjeve, formave dhe metodave të përhapjes së fundamentalizmit islamik në Shqipëri dhe rrezikshmerisë së tij për sigurinë kombëtare. Autori nuk mbetet me kaq, por parashtron edhe strategjinë, rrugët dhe menyrat e parandalimit të përhapjes së kesaj dukurie nga strukturat përgjegjëse të shtetit me mbështetjen e shoqërisë civile dhe të komuniteteve fetare.

Nderkohe, është meritë e autorit që ka ditur që në studimin dhe analizën e këtyre fakteve të mos qendrojë vetëm në rrafshin shqiptar, por t'i lidhë ato me dukuritë analoge në vendet e rajonit e më gjere. Natyrshëm theksohet ideja që lufta kundër kriminit apo terrorizmit nuk mund të jetë e suksesshme pa patur një organizim e bashkëpunim të strukturave të të gjitha shteteve e vendeve. Në këtë drejtim, studimi i z. Shala i kalon kufijtë e vendit tonë.



Metodat analitike të kriminologjisë së aplikuar gjejnë zbatim në trajtimin e veçorive të trafikut të femrave për qëllime prostitucioni në Qarkun e Fierit. Autori, duke qenë për disa kohë edhe në rolin e drejtuesit të lartë të Policisë në këtë qark, sjell me shumë vërtetësi gjendjen e trafikut të qenieve njerezore dhe të femrave për qëllime prostitucioni atje, duke u bërë një analize të thellë dinamikes, veçorive, shkaqeve e pasojave të këtij trafik mizor, i cili nuk njihet asnjë lloj morali, norme apo ligji. Ai, verën autori, është një sfidë e hapur ndaj shtetit ligjor e shoqërisë demokratike.



Edhe për këtë problem të mpërthetë shoqëror z. Shala, jo vetëm ben analizën shkencore të kesaj dukurie, por edhe jep rrugëzgjdhjet e mundshme. Kesisoj, autori ka hartuar dhe implementuar në Fier programin e parë për mbrojtjen e deshmitareve në Shqipëri, duke ngritur Qendren e Pritjes dhe të Mbrojtjes së Viktimave të Trafikut, strategjinë për grumbullimin e armeve të rena në duart e popullsisë në vitin 1997, strategjinë për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike etj.

Duke qenë inicues e hartues i një sere strategjish rajonale e kombëtare të luftës kundër trafikëve të qenieve njerezore, autori ka transmetuar të specialistet dhe koleget e interesuar përvojën e vet, pa e quajtur atë si të vetmen, duke qenë gjithnjë i gatshëm për diskutim.

Problem tjetër që e shqetëson autorin është përhapja e kriminit atavik të hakmarrjes dhe gjakmarrjes. Nepermjet studimit dhe analizës së thellë të kesaj plage të shoqërisë sonë, autori kërkon rrenjet e shkaqet e rishfaqjes së saj, evoluimin, raportet me vrasjet për motive të tjera dhe pasojat për sigurinë kombëtare. Gjithashtu, ai parashtron edhe format, metodat dhe strategjitë që duhet të përdoren për kufizimin dhe ndërprerjen e këtij dukurii shumë të rrezikshëm për demokracinë e brishtë shqiptare.

Autori ben thirrje me force për ndihmesën që duhet të japin të gjithë aktorët dhe faktorët, organet shtetërore, shoqëria civile, komuniteti, media etj., në luftën kundër të gjithë trafikëve të paligjshme, kriminit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve të tjera, që cenojnë jo vetëm sigurinë kombëtare, por dhe vonejone integritimin e Shqipërisë në strukturat euro-atlantike.

E gjithë struktura e këtij botimi interesant, ku harmonizohet drejt trajtimi tekniko – shkencor e profesional me atë aplikativ në fushën e strategjive të policisë në luftën kundër të gjitha krimeve e, veëanerisht, atyre më problematike për vendin tonë, është njëkohësisht edhe deshmi e faktit që shteti shqiptar dhe policia e shtetit, pjesa me e shëndoshe dhe profesioniste e saj i kanë të gjitha mundësitë të dalin fitimtare në luftën me krimin. Kjo ka qenë bindja ime dhe me këtë motiv punova së bashku me specialistet me të mire, kur për afro dy vjet drejtova Ministrinë e Rendit. E, midis tyre, një vend i veëante i takon dhe autorit të këtij libri.

Prandaj, përshendes autorin dhe studiuesin e policisë, z. Xhavit Shala, për ndihmesën që jep në fushën e sigurisë kombëtare, të kerkimeve në fushën e policisë, luftës kundër trafikëve të paligjshme, për vizionet e tij për të ardhmen e policisë etj. Po ashtu e përshendes edhe për faktin se është i pari autor që trajton këto probleme kaq të rëndësishme.

Shpresoj që kjo iniciative kurajoze e tij, jo vetëm që do të vlerësohet e do të mbështetet, por edhe do të pasohet nga punime të tjera të këtij karakteri, për të plotësuar boshllëqet në literaturën profesionale në funksion të punonjesve të policisë, studenteve të Akademisë dhe studiuesve e lexuesve të interesuar në këtë fushë.

Spartak Poçi